

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6243  
E enjte, 18 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

“Newborn”-i merr pamje tjetër, jep mesazh të përkrahjes së UÇK-së | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

REPUBLIKA E KOSOVËS KA SHËNUAR 13-VJETORIN E SHPALLJES SË PAVARËSISË

## 13-VJETORI I PAVARËSISË SHËNOHET PA ISH-KRERËT E UÇK-SË | FAQE 4-5



Republika e Kosovës për herë të parë ka shënuar Ditën e Pavarësisë pa praninë e ish-krerëve të UÇK-së të cilët gjenden në paraburgim në Hagë.

Megjithatë, për nder të 13-vjetorit të shpalljes së pavarësisë liderët e institucioneve dhe të partive kanë bërë homazhe të varrezat e dëshmorëve, duke kujtuar

sakrificën e tyre për liri dhe pavarësi. Ata kanë vlerësuar se pavarësia është rezultat i gjakut të dëshmorëve dhe rezistencës së pathyeshme të popullit të Kosovës

### OPINION

A KA TË NGJASHME NË MES TË OPOZITËS NË SHQIPËRI DHE LËVIZJES VETËVENDOSJE NË KOSOVË? | F. 8

Bedri ISLAMI



### AKTUALE

KMDLNJ: QEVERIA KURTI TË MOS PENGOHET | F. 6

BRENDA 24 ORËVE, PESË TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË | F. 7



### EKONOMI



KOSOVA PO TEJKALON TIPARET E NJË SHOQËRIE TË PAZHVILLUAR | F. 9

EKSPORTET EVROPIANE REGJISTRUAN RËNIE PREJ 9.4-PËRQINDËSH NË VITIN 2020 | F. 9

### KULTURË

‘DARDANËT’, PËR FITORE KUNDËR LUKSEMBURGUT | F. 12

## SHBA-ja DHE BE-ja BËJNË THIRRJE QË DIALOGU ME SERBINË TË JETË PRIORITET I QEVERISË SË RE | FAQE 7



## PARTITË POLITIKE GJOBITEN MBI 120 MIJË EURO PËR THYERJE TË HESHTJES ZGJEDHORE | FAQE 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni: Çdo amerikan do të vaksinohet deri në korrik

WASHINGTON, 17 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara (ShBA), Joe Biden, ka thënë se të gjithë amerikanët do të kenë qasje në vaksinat kundër koronavirusit deri në fund të korrikut. Bideni ka paralajmëruar më herët se vaksinat mund të jenë në dispozicion për të gjithë deri në pranverë, por Shtëpia e Bardhë e shtyu datën për

shkak të vështirësive për pasjen e vaksinave dhe për mundësitë për t'i dhënë ato. "Deri në fund të korrikut do të kemi 600 milionë doza, të mjaftueshme për ta vaksinuar çdo amerikan", ka pohuar Bideni në takimin e parë me votues prejse ka marrë detyrën në muajin janar. Ai ka theksuar se do që shkollat të rihapen më shpejt dhe se mbështet

vaksinimin e mësimdhënësve. Numri i rasteve të reja me koronavirus në ShBA është në rënie, por vazhdon të mbetet në dhjetëra mijëra në ditë. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", numri i viktimave të martën ka qenë pak më pak se 1 000. Koronavirusi ka mbytur mbi 487 000 njerëz në të gjithë ShBA-në.



## Trumpi, sulm të ashpër personal kundër McConnellit

WASHINGTON, 17 SHKURT - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, bëri një sulm të ashpër personal kundër bashkëpartiakut republikan Mitch McConnell. Trumpi e cilësoi atë si "politikan të vrazhdë dhe të mërzhitur" dhe tha se nëse senatorët republikanë vazhdojnë të mbeten me të, ata do të humbin përsëri. Javën e kaluar Senati i Shteteve të Bashkuara e ka shfajësuar Trumpin nga përgjegjësia për nxitjen e trazirave në



Kongresin Amerikan më 6 janar.

McConnell, i cili ka udhëhequr Senatin për katër vjet, ka votuar për shfajësimin e ish-presidentit, por më vonë ka thënë se ai është "moralisht përgjegjës" për trazirat. "Partia Republikane kurrë nuk mund të respektohet ose të jetë e fortë me 'liderë' politikë si senatori Mitch McConnell në krye të saj", ka thënë Trumpi përmes një deklarate për media. "Mungesa e gjykimit politik, mençurisë, aftësisë dhe

personalitetit të McConnellit, u ka kushtuar republikanëve me kontrollin e Senatit, pas zgjedhjeve të nëntorit të kaluar", është shprehur Trump. Më 6 janar, derisa Trumpi ka qenë ende president, mbështetësit e tij kanë sulmuar dhunshëm ndërtesën e Kongresit, ku ligjvënësit po certifikonin fitoren e Joe Bidenit në zgjedhjet presidenciale. Pesë vetë, përfshirë një zyrtar të policisë, kanë mbetur të vrarë në trazira.

## Britania propozon armëpushim në zonat e konfliktit për ta lejuar vaksinimin

LONDËR, 17 SHKURT - Britania e Madhe pritet të kërkojë një rezolutë të Kombeve të Bashkuara, për të ndihmuar në negociimin e armëpushimeve të përkohshme në zonat e konfliktit, në mënyrë që njerëzit atje të vaksinohen kundër koronavirusit. Sekretari i Jashtëm britanik, Dominic Raab, do të kryesojë të mërkurën një takim virtual të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për të diskutuar rezolutën dhe kërcënimin me të cilin përballesh mbi 160 milionë

njerëz që jetojnë në zona të paqëndrueshme dhe të konfliktit, të tilla si Jemeni, Sudani i Jugut, Somalia dhe Etiopia. "Vaksinimi global është thelbësor për ta mposhtur koronavirusin", ka thënë Raab përmes një deklarate. "E kemi detyrë morale për të vepruar dhe domosdoshmëri strategjike për t'u bashkuar në mposhtjen e këtij virusi", ka shtuar ai. Britania është një nga vendet më të suksesshme në botë sa i përket vaksinimit kundër koronavirusit. Derisa

programet e imunizimit vazhdojnë gjetkë, pandemia duket se ka filluar një tërheqje të ngadaltë në disa pjesë të botës.

Në Shtetet e Bashkuara, numri i rasteve të reja të raportuara më 16 shkurt ishte më i ulët që nga fundi i tetorit, ndërsa në Spanjë niveli i infeksionit dyjavor ka rënë në rreth një të tretën e asaj që ishte në fund të janarit.

Koronavirusi ka prekur mbi 109 milionë njerëz në të gjithë botën. Prej tyre, mbi 2.4 milionë kanë vdekur dhe mbi 61 milionë janë shëruar.



## Kina tejkalon ShBA-në si partneri më i madh tregtar i BE-së

Pekin, 17 shkurt - Kina është bërë partneri më i madh tregtar i Bashkimit Evropian, duke tejkaluar Shtetet e Bashkuara. Sipas të dhënave të Zyrës së Statistikave të BE-së, Eurostat, tregtia midis BE-së dhe Kinës ka kapur vlerën e 709 miliardë dollarëve vitin e kaluar, krahasuar me

671 miliardë dollarë importe dhe eksporte me ShBA-në. Për shkak të pandemisë së koronavirusit, Kina ka qenë ekonomia e vetme në botë që ka parë rritje në vitin 2020, çfarë ka nxitur kërkesën për makina evropiane dhe mallra luksoze. Ndërkaq, eksportet e Kinës në Evropë kanë

përfutur nga kërkesat e mëdha për pajisje mjekësore dhe elektronike. "Në vitin 2020 Kina ishte partnerja kryesore e BE-së. Ky rezultat ishte për shkak të rritjes së importeve (+5.6 për qind) dhe eksporteve (+2.2 për qind)", ka njoftuar "Eurostat". Shifrat janë të përafërta me

të dhënat zyrtare të Kinës, të publikuara në janar. Sipas tyre, tregtia e Kinës me BE-në është rritur me 5.3 për qind, në 696.4 miliardë dollarë në vitin 2020. Sipas "Eurostat"-it, deficitin tregtar i BE-së me Kinën, po ashtu, është rritur nga 199 miliardë dollarë në 219 miliardë.



# 'Newborn'-i merr pamje tjetër, jep mesazh të përkrahjes së UÇK-së

Qytetarët këtë vit kanë ngjyrosur monumentin "Newborn" me pëllëmbën e dorës së tyre, me një prej ngjyrave të ushtrisë, duke e treguar në këtë mënyrë përkrahjen për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

PRISHTINË, 17 SHKURT - Monumenti i pavarësisë së Kosovës, "Newborn", i cili gjendet në Prishtinë, pothuajse çdo vit dërgon një porosi nga Kosova për botën. Ky monument, i cili tashmë është simbol i pavarësisë së Kosovës, në 13-vjetorin e pavarësisë dërgon mbështetje për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës.

Qytetarët këtë vit e kanë ngjyrosur monumentin me pëllëmbën e dorës së tyre, me një prej ngjyrave të ushtrisë, duke e treguar në këtë mënyrë përkrahjen për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Një vit më parë Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë konfirmuar aktakuzën për



krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj katër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Të gjithë ata ndodhen në paraburgim në Hagë dhe janë duke u zhvilluar procese gjyqësore ndaj tyre.

"Newborn", i cili simbolizon lindjen e shtetit të Kosovës, u krijua në një kohë rekorde brenda 11 ditëve nga autori Fisnik Ismaili. "Newborn"-i u zbulua më 17 shkurt 2008, në ditën kur Kosova shpalli pavarësinë. Atë ditë mbi 150 mijë njerëz u nënshkruan në këtë

monument. Të parët që nënshkruan ish-presidenti Fatmir Sejdiu dhe kryeministri i atëhershëm Hashim Thaçi.

"Newborn"-i është ndërtuar nga një skelet çeliku dhe është i mbuluar me shtresë metali prej 4mm. Çdo shkronjë ka lartësi prej tri metrash, që peshon përafërsisht një ton. Ky është monumenti më i vizituar në Kosovë.

Prej 17 shkurtit 2008, shtatë shkronjat e këtij obelisku nuk ndryshuan pamjen deri në përvjetorin e pestë të pavarësisë së Kosovës.

Autori i këtij monumenti, Fisnik

Ismaili, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se qysh në fillim kishin dy ide si do të vazhdohej të jetësohej ky monument. Ideja e parë, sipas Ismailit, ishte që të ruheshin nënshkrimet e 17 shkurtit 2008, duke e konservuar monumentin, por pasi që nuk u arrit të konservohet, u mendua që "Newborn"-i të ndryshojë pamje çdo vit.

Arsyeja se pse pamja e "Newborn"-it nuk ndryshoi për pesë vjet, siç thotë Ismaili, ishte neglizhenca e autoriteteve për të formuluar një plan të qartë dhe një praktikë për mirëmbajtjen e monumentit.

## KQZ-ja: Pas disa ditësh dihet numri i saktë i fletëvotimeve nga diaspora

PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka nisur vlerësimi i pakove me fletëvotime të cilat kanë ardhur përmes postës nga 2 deri më 12 shkurt ka bërë me dije zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi. "Në QNR shërbimi votues i KQZ-së ka filluar procesin e vlerësimit të pakove të supozuara me fletëvotime dhe selektimin e tyre, të cilat kanë ardhur nga jashtë Kosovës gjatë periudhës së votimit përmes postës nga 2 deri më 12 shkurt. Ky proces ka për qëllim të verifikojë nëse pakot në fjalë janë dërguar nga votuesit e regjistruar suksesshëm si votues jashtë vendit apo nëse pakot e dërguara plotësojnë kriteret ligjore. Në fund të këtij procesi të vlerësimit, i cili do të na marrë kohë disa ditë, do të dimë se sa është numri i saktë i fletëvotimeve nga jashtë vendit",



ka thënë Elezi.

Sipas tij, në këtë qendër po vazhdon procedimi i të dhënave të formularëve të subjekteve politike dhe kandidatëve për deputetë. "Nga 2 e 382 vendvotime, deri më tani janë proceduar të dhënat e formularëve të subjekteve politike

për rreth 1 056 vendvotime (44.33 për qind) si dhe të dhënat nga formularët e kandidatëve për rreth 841 vendvotime (35.11 për qind)", ka thënë Elezi.

Ndërsa në lidhje me gjendjen e vendvotimeve, Elezi ka thënë se prej gjithsej 2 382 vendvotimeve, vetëm 80 prej tyre nuk kanë

mundur të procedohen si të rregullta. "Nga 2 e 382 vendvotime, një numër i vogël i tyre, vetëm rreth 80 sosh, nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta për arsye të ndryshme: mospërputhje të nënshkrimeve apo formularë të rezultateve të panënshkruara

nga anëtarët e këshillit të vendvotimit. Këto vendvotime do të shikohen më në hollësi për problemet që kanë dhe në bazë të të gjeturave do të përgatitet një raport me rekomandime i cili do të paraqitet në KQZ", ka thënë zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi.



REPUBLIKA E KOSOVËS KA SHËNUAR 13-VJETORIN E SHPALLJES SË PAVARËSISË

## 13-vjetori i pavarësisë shënohet pa ish-krerët e UÇK-së

Republika e Kosovës për herë të parë ka shënuar Ditën e Pavarësisë pa praninë e ish-krerëve të UÇK-së të cilët gjenden në paraburgim në Hagë. Megjithatë, për nder të 13-vjetorit të shpalljes së pavarësisë liderët e institucioneve dhe të partive kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve, duke kujtuar sakrificën e tyre për liri dhe pavarësi. Ata kanë vlerësuar se pavarësia është rezultat i gjakut të dëshmorëve dhe rezistencës së pathyeshme të popullit të Kosovës



fituan", ka thënë Osmani. Ajo ka falënderuar në veçanti aleatët të cilët ndihmuan në çlirimin e Kosovës.

Osmani ka deklaruar se u është përjetë mirënjohës NATO-s, ShBA-së dhe Evropës ngaqë pavarësia e Kosovës nuk mund të imagjinohej pa ndihmën e tyre.

Në fund të adresimit të saj, Osmani ka folur për synimet e FSK-së dhe shtetit të Kosovës.

"Forca e Sigurisë së Kosovës është ushtria më e re në botë dhe po kalon nëpër periudhën e tranzicionit dhjetëvjeçar. Por, gjatë gjithë kësaj kohe FSK-ja, krahas ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të veta, po punon edhe për realizimin e synimit strategjik të anëtarësimit në NATO. Shpresojmë dhe besojmë që në një të ardhme të afërt ushtarët tanë do të jenë krahas atyre të NATO-s, kudo që ka nevojë për ta mbrojtur paqen botërore. Synimi i vendit tonë është integrimi në bashkësinë e popujve evropianë", ka thënë ajo.

Kurse kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka deklaruar se përvjetorët janë çaste të veçanta për t'i kujtuar ata që sakrifkuan çdo gjë për realizimin e aspiratës shekullore për liri dhe pavarësi. "Pavarësia e Kosovës është një ëndërr e realizuar e gjeneratave që sakrifkuan çdo gjë, ndërkohë që mbetet shumë punë për ta

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 17 SHKURT** - Republika e Kosovës ka shënuar 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë. 13-vjetori i shpalljes së pavarësisë ka qenë ndryshe nga përvjetorët e tjerë. Për herë të parë kjo festë është shënuar pa protagonistin kryesor të shpalljes së pavarësisë, ish-kryeministrin Hashim Thaçi, i cili, së bashku me ish-kryeparlamentarin, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, gjenden në paraburgim në Hagë.

Dita më e rëndësishme në historinë politike të Kosovës është shënuar me disa aktivitete. Fillimisht është bërë ngritja e flamurit shtetëror nga Garda Ceremoniale e FSK-së, në të cilën

kanë marrë pjesë ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti dhe liderët të tjerë institucionalë. Më pas, ata kanë bërë homazhe te varri i ish-

presidentit Ibrahim Rugova dhe te Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

Manifestimi qendror me ceremoni ushtarake është mbajtur në Kazermën "Adem

Jashari" në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka përmendur sakrificën e gjeneratave për pavarësi. "Pavarësia e vendit nuk do të arrihej pa rezistencën qytetare të prirë nga presidenti Ibrahim Rugova, pa sakrificën sublime të djemve dhe vajzave të UÇK-së dhe komandantit Adem Jashari me familje, por edhe të heronjve e dëshmorëve të tjerë të vendit, pa të cilët liria do të mbetej vetëm ëndërr! Kjo nuk do të ishte e mundshme as pa kontributin e të gjithë qytetarëve të Kosovës, ngaqë secili nga ta bëri diçka për ta vendosur një gur në projektin e pavarësisë së vendit! Ata guxuan, prandaj



realizuar aspiratën për integrimet euroatlantike të Kosovës. I tillë ishte vizioni dhe amaneti i heronjve tanë, të cilët na ndriçuan rrugën në luftën çlirimtare. Por, ambicia e tyre nuk mbaron këtu. Kjo ambicie rritet dhe zhvillohet çdo ditë ashtu siç po konsolidohet dhe avancohet demokracia, si vlera më e lartë dhe më e çmuar e gjithë historisë njerëzore”, ka thënë kryeministri Hoti.

Ai ka falënderuar të gjithë ata që kanë dhënë kontribut për arritjen e pavarësisë së Kosovës. “Prandaj, sot, në përvjetorin e 13 të shtetësisë së Kosovës, festojmë ëndrrën e realizuar të heronjve, që shprehet si një gërshetim i

### Liderët urojnë qytetarët për Ditën e Pavarësisë

Përveç liderëve institucionalë, edhe ata partiakë kanë uruar qytetarët për Ditën e Pavarësisë. Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se në këtë përvjetor me mendje dhe zemër është me ish-liderët e kësaj partie, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, të cilën gjenden në paraburgim në Hagë. “Sot kur festojmë 13 vjet shtetësi, me zemër e mendje jemi me liderët e Kosovës që padrejtësisht gjenden në Hagë. Për 13 vjet me radhë, Hashim Thaçi e Kadri Veseli punuan çdo



vlerave për shërbimin dhe dashurinë për atdheun, për t'ua dhënë mundësinë këtyre djemve dhe vajzave për t'u rreshtuar me krenari në radhët e ushtrisë, që forcon themelet e shtetit tonë. Edhe në këtë përvjetor kujtimi dhe mirënjohja për kontributin e pashembullt na bëhen udhërrëfyes që na jep forcë për ta ngritur flamurin e Kosovës përkrah vendeve më të fuqishme për ta garantuar paqen dhe sigurinë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare”, ka thënë Hoti.

ditë për zhvillimin e shtetit dhe mirëqenien e qytetarëve. Çdo moment të jetës së tyre ia kushtuan përmëshjes së amanetit të dëshmorëve për liri dhe pavarësi. Këtë premtim do të vazhdojmë ta mbajmë dhe ta jetësojmë çdo ditë si Parti Demokratike, pasardhëse e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ka shkruar Enver Hoxhaj në profilin e vet në “Facebook”. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, në urimin e tij ka thënë se shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 shënon një nga momentet më të



rëndësishme në historinë më të re të Kosovës. “Rruga deri te pavarësia ishte me sakrificë dhe mund i një populli të tërë i cili nuk kurseu as jetën për ta çliruar shtetin. Projektues i pavarësisë dhe i themelimit të shtetit të Kosovës është arkitekti i saj, dr. Ibrahim Rugova. Ai me vizionin e tij properëndimor fitoi mbështetjen e jashtëzakonshme ndërkombëtare, sidomos nga ShBA-ja, që ta përkrahë Kosovën për arritjen e lirisë, për krijimin e shtetit dhe po vazhdon konsolidimin e tij. U jemi mirënjohës përjetësisht familjes së komandantit legjendar Adem Jashari, dëshmorëve të kombit dhe të gjithë atyre që dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në përpjekjet e tyre të pareshtura për liri, çlirim dhe shtetndërtim”, ka thënë Mustafa në urimin e tij. Për nder të kësaj dite, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vizituar disa vendbanime të rëndësishme. “Për festën e pavarësisë nderuam të rënë për liri në Reçak, Glogjan, Prekaz, Klinë, Prejlep dhe përmbyllëm nderimet në Prishtinë, te varri i presidentit historik Ibrahim Rugova. Takuam qytetarë të të gjitha moshave, të gëzuar për festë dhe me shpresë për të ardhmen. Në bashkëbisedim me ta, shpreha

bindjen time se Kosova do të ecë në rrugën e zhvillimit, integrimin në NATO e BE dhe bashkimit me Shqipërinë. Kosovë, urime 13-vjetori i pavarësisë!”, ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në “Facebook”.

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka uruar qytetarët për 13-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. “Sot bëhen 13 vjet nga shpallja e

pavarësisë së Kosovës, e cila shënon të arriturën më të madhe në historinë e shtetit tonë. Shpallja e pavarësisë 13 vjet më parë është kurorëzim i përpjekjeve të popullit shqiptar që kulmuan me luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari dhe mijëra dëshmorë të tjerë”, është thënë në mesazhin e Limaj.

## Kurti: Familja Jashari na përkujton se sa është i lartë çmimi për liri

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se familja Jashari është vendi i kushtimit për çlirim dhe vendi që e përkujton se sa i lartë është çmimi për liri. Pas homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, ai ka thënë se sot festohet 13-vjetori i pavarësisë që i ka rrënjët te gjaku i martirëve dhe dëshmorëve. “Tre breza të familjes Jashari luftuan dhe u sakrifkuan për liri. Gjysma e kësaj familje që ranë ishin burra dhe gjysma tjetër ishin gra dhe

fëmijë”, ka thënë ai, duke përmendur arsyen e vizitës në këtë kompleks. “Duke u rikthyer në këtë vend, ne e bëjmë më të fuqishëm shtetndërtimin tonë demokratik, zhvillimin socio-ekonomik dhe drejtësinë në institucione, sepse i tillë është amaneti i dëshmorëve, por edhe dëshirat dhe nevojat e popullit shqiptar janë të tilla”, ka thënë Kurti. Homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” kanë bërë edhe liderët e tjerë partiakë.



# Partitë politike gjobiten mbi 120 mijë euro për thyerje të heshtjes zgjedhore

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është gjobitur 42 500 euro, Lëvizja Vetëvendosje (LV) 37 500 euro, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) 22 000 euro, Nisma Socialdemokrate 2 000 euro dhe Lista Serbe 1 000 euro



Sipas të dhënave preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka fituar zgjedhjet e 14 shkurtit rreth 48 për qind të

votave. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka fituar 17.35 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës 13.18 për qind të votave. Në vendin e katërt

është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.42 për qind të votave, ndërkaq Nisma Socialdemokrate nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor prej 5-përqindësh.

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 SHKURT - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka njoftuar të mërkurën se si pasojë e ankesave për thyerje të heshtjes zgjedhore në Kosovë, për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, partitë politike janë gjobitur me mbi 120 mijë euro.

Ky institucion ka pranuar 134 ankesa për shkelje të heshtjes zgjedhore nga ana e partive politike, mirëpo ka pranuar si të bazuara 177 prej tyre.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është gjobitur 42 500 euro, Lëvizja Vetëvendosje (LV) 37 500 euro, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) 22 000 euro, Nisma Socialdemokrate 2 000 euro dhe Lista Serbe 1 000 euro.

“Natyra e ankesave të paraqitura ka qenë: heshtja zgjedhore, thyerja e heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit për ta votuar subjektin e caktuar politik, thirrja për të votuar disa kandidatë nëpërmjet portaleve të gazetave, shpërndarja apo postimi i disa fotografive me aktivitet elektoral në rrjetin social ‘Facebook’, thirrje nëpërmjet rrjetit social ‘Facebook’ për të votuar, bërja e fushatës me veturë 100 metra afër qendrës së votimit, shpërndarja e ‘SMS’-ve të qytetarët për votim, vendosja e banerëve me fotografi të kandidatëve në afërsi të shkollës, vendosja e posterëve të kandidatëve në oborrin e qendrës së votimit, mbajtja e fushatës gjatë ditës së votimit”, është thënë në njoftimin për media.

## KMDLNj: Qeveria Kurti të mos pengohet



PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se pas zgjedhjeve të 14 shkurtit situata politike në vend është qartësuar shumë. “Pozita e ardhshme ka siguruar pushtet absolut duke udhëhequr ekzekutivin, me fuqi të madhe në Kuvendin e Kosovës dhe duke e marrë edhe postin e presidentit. Pozita e ardhshme ka deklaruar se nuk do të bëjë koalicion me asnjë parti shqiptare duke e marrë përgjegjësinë e plotë për të gjitha proceset dhe vendimmarrjen në Kosovë”, thuhet në komunikatën e KMDLNj-së.

Ky këshill ka kërkuar që opozita

e ardhshme të tregohet konstruktive dhe bashkëpunuese e plotë në procesin e formimit të institucioneve. KMDLNj shpreson se opozita e ardhshme në mënyrë unanime duhet ta votojë Qeverinë Kurti 2, Albin Kurtin për kryeministër sikurse edhe Vjosa Osmanin për presidente. Gjithashtu, KMDLNj ka kërkuar që çështja Kurti të mos dërgohet në Gjykatën Kushtetuese, sepse pa nevojë vonohen proceset e tjera e që duket se do të jenë përgjegjësi absolute e pozitës së ardhshme. “Do të ishte shumë mirë, politikisht dhe moralisht që qeveria e ardhshme të mos pengohet, jo në 100 ditët e

ardhshme, por në 12 muajt e ardhshëm. Opozita e ardhshme, me deklaratën përjashtuese të kryeministrit të ardhshëm, lirohet nga çdo përgjegjësi në planin e vendimmarrjes e që i lë mundësi për konsolidim të opozitës për zgjedhjet e ardhshme lokale. Në demokraci, votuesi i përcakton rregullat e lojës politike, ndërsa të zgjedhurit duhet t’i zbatojnë ato. Në rastin konkret është përcaktuar qartë adresa e vendimmarrjes dhe përgjegjësisë andaj çdo përpjekje për pengim të procesit është dhunim i vullnetit të shumicës”, është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

## Më 24 shkurt secanca e radhës ndaj Gucatit e Haradinajt, më 5 mars ndaj Mustafës

PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - Gjykata Speciale ka caktuar seancën e radhës ndaj Nasim Haradinajt, Hysni Gucatit dhe Salih Mustafës. Sipas një njoftimi në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara, konferenca mbi ecurinë e çështjes për dy ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK), Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, është caktuar për datën 24 shkurt në orën

11:00. Ndërkaq për rastin ndaj Salih Mustafës është caktuar seancë për ecurinë e çështjes më 5 mars në orën 11:00.

Gjykata Speciale ka mbajtur të premtën konferencën e tretë statusore ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së është ankuar se prokuroria po ua vështirëson hetimet. Avokatët kanë kërkuar që prokuroria ta

dorëzojë sa më shpejt dosjen paraprake të lëndës në mënyrë që ata të mund të përgatiten për hetimin. Prokuroria ka bërë me dije se dëshmitarët janë arsyeja kryesore që dorëzimi i dosjes paragjyqësore apo paraprake duhet të lidhet me datën e gjykimit, ndërsa mbrojtja ka vlerësuar se frikësimi i dëshmitarëve është slogan dhe se nuk ka të bëjë me realitetin.



# ShBA-ja dhe BE-ja bëjnë thirrje që dialogu me Serbinë të jetë prioritet i qeverisë së re

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 SHKURT - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, partia e të cilit i ka fituar zgjedhjet parlamentare në Kosovë më 14 shkurt, ka thënë se formimi i ekipit negociues për dialogun me Serbinë nuk është prioritet i tij, duke shtuar se është "prioritet i gjashtë ose i shtatë" për qytetarët e Kosovës. "Prioritetet tona janë punësimi dhe drejtësia", ka deklaruar Kurti.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm drejt një të ardhmeje më të begatë, më të qëndrueshme dhe të sigurt.

Blinken ka thënë se ShBA-ja e përgëzon Kosovën për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin, ndërsa duartroket edhe përpjekjet e saj për t'i normalizuar marrëdhëniet me Serbinë. "Arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, e përqendruar në njohjen reciproke, do të kërkojë nga të gjitha palët të demonstrojnë fleksibilitet dhe gatishmëri për kompromis", ka deklaruar Blinken. Ai i bëri këto

komente në një letër dërguar autoriteteve të Kosovës, me rastin e 13-vjetorit të shpalljes së pavarësisë. "Shtetet e Bashkuara i vlerësojnë lidhjet e forta midis njerëzve tanë dhe do të vazhdojnë ta mbështesin Kosovën në rrugën e saj drejt integritit euroatlantik", ka pohuar Blinken.

Një ditë më herët, Kosovën e uroi edhe presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, i cili shprehu gatishmërinë për të punuar me Qeverinë e re të Kosovës në rrugën e integritit evropian.

Edhe Bashkimi Evropian pret që dialogu të jetë ndër prioritetet kryesore, u pa edhe në reagimet e para nga Brukseli zyrtar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të së dielës. Në një komunikatë të përbashkët, të lëshuar nga përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell dhe komisionari për Zgjerim dhe Fqinjësi, Oliver Varhelyi, përmendet dialogu si një nga çështjet për të cilat presin angazhim konstruktiv të qeverisë së re. "Rruga evropiane e Kosovës po ashtu shkon edhe përmes normalizimit gjithëpërfshirës të raporteve me



Serbinë dhe BE-ja pret nga autoritetet në Prishtinë që të angazhohen në mënyrë konstruktive, me qëllim të vazhdimit të takimeve në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe ta shfrytëzojnë rastin që kanë përpara për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse", thuhet në komunikatën për medie.

Kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka thënë se është për keqardhje që lideri i partisë fituese të zgjedhjeve në Kosovë, njëherësh kandidat për

kryeministër, Albin Kurti, ka thënë se vazhdimi i dialogut me Serbinë nuk është një përparësi e tij. "Mendoj se ky është joserioziteti i elitave politike në Prishtinë. Dialogu është mënyra e vetme për të pasur një marrëveshje për normalizim, që do të nënkuptonte më shumë begati, përparim ekonomik dhe stabilitet. Unë nuk e di se çfarë tjetër mund të ishte prioritet më i madh", ka deklaruar Bërnabiq. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian, kishte

filluar para dhjetë vjetësh. Pas një ngecjeje gati dyvjeçare, procesi rifilloi verën e vitit të kaluar. Por, për shkak se Kosova shkoi në zgjedhje të parakohshme parlamentare, raunde të reja të bisedimeve në nivel të lartë nuk ka pasur që nga vjeshta e vitit të kaluar, ndërkohë që janë zhvilluar vetëm disa takime në nivel të ekspertëve. Deri në zgjedhjen e Qeverisë së re të Kosovës, Brukseli zyrtar ka paralajmëruar se nuk do të ketë takime në kuadër të dialogut.

## Brenda 24 orëve, pesë të vdekur nga Covidi në Kosovë

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar

gjithsej 2 667 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 297 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të

vdekurve janë nga komunat: Prishtinë dy raste (81, 53 vjeç), Ferizaj një rast (79 vjeç), Rahovec një rast (80 vjeç) dhe Suharekë një rast (57 vjeç).


Numri total i rasteve pozitive është 65 065 raste nga 274 160 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 553 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë

shëruar 311 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 56 655 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 6 857.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 106 raste, Prizren 20 raste, Gjakovë 19 raste, Pejë 17 raste, Mitrovicë 16

raste, Fushë-Kosovë 15 raste, Gjilan 15 raste, Ferizaj 14 raste, Vushtrri 13 raste, Klinë 9 raste, Lipjan 8 raste, Rahovec 8 raste, Podujevë 7 raste, Obiliq 6 raste, Istog 5 raste, Skenderaj 4 raste, Suharekë 4 raste, Viti 4 raste, Drenas 2 raste, Hani i Elezit 2 raste, Malishevë 2 raste dhe Kamenicë 1 rast.

# A ka të ngjashme në mes të opozitës në Shqipëri dhe Lëvizjes Vetëvendosje në Kosovë?



**Bedri ISLAMI**

Ka një entuziazëm të ngutshëm te opozita në Shqipëri për të gjetur veten në fitoren, thaj plebishitare, të Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit në Kosovë. Ndërlidhja e asaj që ndodhi më 14 shkurt në Prishtinë dhe çfarë do të mund të ndodhë më 25 prill në Tiranë, po merr përmasa fantaziste, të cilat, edhe pse mund t'u duket se do të jenë vazhdim i njëra-tjetrës, më shumë se gjithçka tjetër, do t'i dëmtojë vetë ata.

Është e vërtetë se Albin Kurti e sidomos Vjosa Osmani, pas vizitës në Shqipëri, janë shumë më afër opozitës sesa shumicës qeverisëse. Kurti është që në krye të herës, kur nga një "dashuri platonike" me Edi Ramën, i cili e quajti një herë politikanin më të kompletuar të Kosovës, u kalua në një ndasi akujsh, e cila erdhi duke u bërë gjithnjë e më therëse derisa, disa muaj më parë, u kthye në një akullnajë, e cila nga askush në lojën politike nuk e di se si do të shkrihet.

Kurti, çuditërisht, e ka gjetur veten më pranë Berishës sesa Ramës dhe kjo nuk ka të bëjë asfare me idetë që u hodhën në media për idenë e ndarjes së kufijve, pasi asnjë ide të tillë, veçse mediatikisht nuk ka pasur. Më tepër sesa ndodhi ishte një "shpallje lufte" për njeriun që në Tiranë njihej si mentor i Thaçit dhe ky i fundit ishte kundërshtari i përbetuar i Kurtit

që në janarin e vitit 1999. Pas 22 vjetëve, tani, më 14 shkurt, Kurti mori "hakun" e asaj që kishte nisur në ditët e Rambujesë kur, pas kundërshtimit të Adem Demaçit për Rambujenë dhe propozimit të tij, si një pajtesë e çastit që në vendin e tij të ishte Albin Kurti dhe kundërshtimin e Thaçit, nisi sherrnaja, dhe mirë bëri që nisi, pasi 22 vjet më pas kemi një përmbysje të detashmentit qeverisëse, që më shumë e trajtoi Kosovën si domenin e saj sesa e të gjithëve në një fillësë të barabartë.

Që Kurti, e pas tij Osmani, janë krah opozitës dhe, që thajse dy vjet më parë bënë thirrje për pranverën shqiptare, kjo dihet. Ajo që përbën ende enigmë është në të fshehtë se çfarë e lidh një forcë politike të së majtës në Kosovë, me një forcë politike që është kundërshtarë e saj; çfarë të përbashkët mund të ketë brezi i vitit 1998 në Kosovë dhe 80-vjeçarët e Tiranës; cila është lidhja mes të rinjve kryengritës në Prishtinë dhe "kryengritësve inatçorë" në Tiranë? Por, politika, aq sa është arti i të mundshmes, aq është edhe arti i paradigmave dhe i enigmave.

Mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe Listës Vjosa, në njërin anë dhe forcave opozitare në Tiranë ka përngjasime të pakta, tejet të papërfillshme, ashtu si ka ndasi të mëdha dhe të kundërta të skajshme.

Kurti dhe Lëvizja e tij politike, ku zonja Osmani është shtesë e çastit dhe praktikizëm politik, rrëzuan një tërësi të vjetër politike, e cila, prej 20 vjetëve, përmes alternimeve dhe tkurrjeve e bashkimeve kishte qeverisur Kosovën, duke humbur shumë nga aspiratat e ngritura nga lufta çlirimtare.

Kjo klasë politike duhej

ndëshkuar. Në Kosovë duhej ndryshimi, si domosdoshmëri! Edhe nëse zoti Kurti nuk i realizon dot aspiratat e tij në përmasat e premtuara, përsëri Lëvizja sollti dobinë e parë të madhe: rrëzoi një klasë politike, e cila, në më shumë se gjysmën e popullsisë, kishte humbur besimin dhe ishte bërë e padurueshme.

Njerëzit, sidomos të rinjtë, e kishin humbur besimin dhe donin të besonin dikë tjetër që sillej ndryshe, besonte ndryshe, artikulonte ndryshe dhe rebelohej ndryshe. Një forcë politike, ku shumica janë të rinj dhe aspirues të ndryshimit, ishte edhe shenja e parë e besimit. Për më tepër, një vit më parë ajo mjeshtërisht u paraqit si një forcë politike që heq dorë nga pushteti për ta ruajtur parimin dhe vizionin, duke e ditur se nuk mund të qeveriset me vjetërsi politike dhe se kthimi do të ishte në kohën e duhur.

Të gjithë statutat kryesore politike të Lëvizjes Vetëvendosje janë të rinj, aspirues ndryshimi. Edhe figura të njohura të kohës së rezistencës, si Emrush Xhemajli, Hydajet Hyseni, Gani Krasniqi, Sabri Kiçmari etj., janë shëmbëlltyra të një jete të ndershme. Në opozitën e tanishme, për fat të keq, megjithëse duket se loja luhet në selinë e Shqipit të dikurshëm, në fakt fijet tërhiqen nga lideri 80-vjeçar, i cili nuk e ka më as kohën dhe as mendësinë për të sjellë të renë, vizionin dhe përkushtimin. Nëse opozita pret që ta fitojë betejën dhe të kthehet në pushtet përmes "qytetarit digjital", ajo do të duhet të presë edhe shumë e shumë katërvjeçarë të tjerë.

Të rinjtë e Lëvizjes Vetëvendosje, thajse të gjithë, janë figura të njohura, por të

papërljera në afera të ndryshme financiare. Megjithëse në qeverinë e parë të Kurtit kishte figura kontestuese, kishte fillimisht shfaqje intolerance, ajo përbëhej nga njerëz që ishin të përkushtuar, si Albulena Haxhiu apo Glauk Konjufca. Me cilët do t'i shkëmbente opozita e tanishme këto figura: me Nard Ndokën, Dash Shehin apo Vangjel Dulen? Në cilat afera nuk ka qenë e përfshirë opozita kur ishte në pushtet? Cili prej tyre nuk është sot ndër pasunarët e pamerituar dhe cili do të kishte emër të njohur nëse nuk do të kishte qenë në politikë?

Dallimi tjetër, i cili duhet ta ftohë entuziazmin dhe të gjenden rrugë të tjera për ta ndryshuar gjendjen, është mes vizionit të liderit; nga njëra anë kemi një drejtues partie të komanduar, që edhe kur humbi zgjedhjet e vitit 2017 nuk u tërhoq, por bëri rikthimin përmes mbushjes së kutive dhe ngrirje 0 shkrirjes, ndërsa nga ana tjetër, Kurti, me gjithë shenja e autokracisë, është një figurë që e ka ndërtuar vetë godinën e strukturën e partisë së tij.

Dikur, kur donin të blinin një shtëpi, blerësit pyesnin: E ke ndërtuar vetë apo ta ka ndërtuar babai?

Nëse e kishte ndërtuar vetë çmimi do të ishte i lartë, nëse do ta kishte dhuratë, çmimi do të ishte i ulët, pasi nuk i dije mundimet e ngritjes së shtëpisë. Kurti e ka ngritur vetë, ka pritur 20 vjet që të jetë aty ku është; Basha e gjeti gati, ia kaloi si me testament politik ati i tij politik; Kryemadhi, edhe më tej, si dhuratë familjare, dhe as njëri e as tjetri nuk i forcuan strukturat politike e as organizative. Vegjetuan, kur Rama përgatiti

gjithçka.

Kurti, shumë gjatë, e Osmani, disa javë, luftuan brenda strukturave, edhe duke i shkelur ligjet, u rrëzuan, u përjashtuan, nuk u vetëpërjashtuan asnjëherë. Tymueset ishin shenja të rebelimit e ndoshta të padurimit ndaj pushtetit, por kurdoherë të motivuara për qëllime kombëtare. "Molotovët" e Bashës kundërshtonin largimin nga detyra të një kryeprokurori të korruptuar, shkonin deri në synimin për zaptimin nga jashtë të parlamentit, ndërsa Kurti protestën e tij e paraqiste kundër demarkacionit, vendosjes së mbrapshtë të kufirit me Malin e Zi. Kurti qëndroi në parlament dhe përmes parlamentit rrëzoi qeverinë Hoti, pikërisht kur e kuptoi se kishte ardhur koha e duhur. Nëse do të kishte vepruar më parë mund të ishte i ngutur; nëse do të kishte vepruar më pas mund të ishte i vonuar.

Basha dhe Kryemadhi nuk e kuptojnë kurrë se kur janë të vonuar, as kur janë të ngutur. Katër muaj para Bashës ngriti shefi i qeverisë drejtuesit e grupet e punës për zgjedhjet e 25 prillit, ndërsa Basha në momentin e fundit. Rama përcaktoi me cilët do të punonte që në krye të herës, afaristë, biznesmenë, oligarkë, njerëz me reputacion, të fortë, ndërsa Basha, edhe aleatin e tij të vetëm besnik në të gjitha situatat, Mehdiun, ngurroi deri në fund, kur duhej ta kishte nisur nga ai. Mes dy palëve ka ndasi të mëdha dhe sa më shpejt ta kuptojë këtë trupa drejtuese e opozitës, aq më mirë do të ishte. Edhe për të, sepse është koha e reformimit, edhe për vendin, që ndien mungesën e opozitës serioze.





## Kosova po tejkalon tiparet e një shoqërie të pazhvilluar

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 SHKURT - Eksperti i ekonomisë, Muhamet Mustafa, ka folur për përparimin dhe ngecjen në ekonomi gjatë 13 vjetëve të pavarësisë së Kosovës. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se për t'i përballuar sfidat ekonomike Kosova do të duhej të kishte rritje ekonomike 6-7 për qind. "Kosova po i tejkalon ngadalë dhe me vështirësi tiparet e një shoqërie të pazhvilluar. Sipas kriterëve të Bankës Botërore, Kosova po hyn në grupin e vendeve me të ardhura mesatare të larta. Pra, me një

GDP mbi 4 000 dollarë për banor, por në matriksin social mbesin shumë kundërthënie të një shoqërie që ka vuajtur historinë e vështirë dhe pas çlirimit edhe luftën primitive politike që injoron interesat madhore nacionale", u shpreh ai.

Mustafa ka thënë se zhvillimet ekonomike pas shpalljes së pavarësisë janë karakterizuar me një rritje ekonomike të vazhdueshme, por të pamjaftueshme për të krijuar vende të reja të punës që i kërkojnë kontingjentet e reja që hyjnë në tregun e punës. "Rritja ekonomike do të duhej të sillej 6-7 për qind për të adresuar këto probleme, ndërsa ajo që

kemi arritur këto vite të pavarësisë ka qenë të shumtën e rasteve 3-4 për qind", u shpreh ai.

Ai ka deklaruar se lufta për pushtet politik, keqmenaxhimi i ndërmarrjeve publike dhe korrupsioni janë ndër faktorët të cilët kanë ndikuar që në Kosovë të ketë pak investime të huaja. "Dobësitë në qeverisjen makroekonomike, dobësitë e klasës politike të kapluar me luftën primitive partiake për pushtet, qeverisja e keqe e ndërmarrjeve publike dhe e pronës publike dhe korrupsioni i lidhur me to dhe paranë publike, kanë ndikuar që Kosova të investojë më pak se do të duhej", u shpreh ai.

Ndërsa si faktorë që kanë ndikuar në rezultatet pozitive në ekonomi, Mustafa ka numëruar politikën tatimore dhe investimet në infrastrukturë, edhe pse vërejtje ka dhënë për koston e lartë të tyre. "Duke filluar nga viti 2015 ka vazhduar një kujdes ndaj politikave dhe strategjive industriale që duhet ta rrisin ofertën vendore, rrisin eksportet dhe krijojnë më shumë vende pune. Paket fiskale kanë dhënë tanimë disa rezultate pozitive. Kur bëjmë bilancin 13-vjeçar, nuk duhet harruar edhe të arriturat për zhvillimin e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, që kanë krijuar disa parakushte për

zhvillim të mëtejme. Mos të harrojmë se ky cikël investimi që filloi pas pavarësisë, ishte vonuar së paku 20 vjet. Mirëpo ndërtimi i kësaj infrastrukture konsiderohet se i ka kushtuar shumë shtrenjtë buxhetit (ndoshta rreth 30 për qind më shumë sesa do të duhej) dhe ka reduktuar fondet buxhetore për arsim dhe shëndetësi", u shpreh Mustafa. Sipas tij, Kosova po tejkalon tiparin e një shoqërie të pazhvilluar. "Duhet ta shohim rrugën e kaluar, t'i nxjerrim mësimet nga pësimet dhe me politika e qeverisje të përgjegjshme ta vëmë vendin tonë në radhën e shoqërive të zhvilluara", ka thënë eksperti i ekonomisë, Muhamet Mustafa.

## Eksportet evropiane regjistruan rënie prej 9.4-përqindësh në vitin 2020

PRISHTINË, 17 SHKURT - Eksportet e Bashkimit Evropian u ulën me 9.4 për qind vitin e kaluar për shkak të Covid-19. Zyra Evropiane e Statistikave ka njoftuar se eksportet totale në Eurozonë u ulën me 9.2 për qind krahasuar me një vit më parë, në 2 trilionë e 131.4 miliardë euro, kurse importet totale ranë me 10.8 për qind në 1 trilion e 897 miliardë euro, ndërsa teprica tregtare e Eurozonës në vitin 2020 arriti në 234.5 miliardë euro. Në këtë vit eksportet totale të BE-së u ulën me 9.4 për qind krahasuar me vitin e kaluar në 1 trilion 931.6 miliardë euro, ndërsa importet e saj u ulën me 11.6 për qind në 1 trilion 714.3 miliardë euro, me çka BE-ja

përfitoi një suficit tregtar prej 217.3 miliardë eurosh në periudhën janar-dhjetor 2020. Importuesit kryesorë nga vendet e BE-së vitin e kaluar ishin ShBA-ja me 353 miliardë euro, Britania e Madhe me 277.5 miliardë euro, Kina me 202.5 miliardë euro, Zvicra me 142.4 miliardë euro, Rusia me 79 miliardë euro, Turqia me 69.9 miliardë euro dhe Japonia me 54.5 miliardë euro. Vendet me eksportet më të larta në vendet e BE-së janë Kina me 383.5 miliardë euro, ShBA-ja me 202 miliardë euro, Britania e Madhe me 167.2 miliardë euro, Zvicra me 108.6 miliardë euro, Rusia me 95.2 miliardë euro dhe Japonia me 54.9 miliardë euro.




## Lladrovci nderon dëshmorët

DRENAS, 17 SHKURT (ER) - Për nder të 13-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, me kabinetin e tij, drejtorë të drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe qytetarë, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule të freskëta në varrezat e dëshmorëve në Komunën e Drenasit.

Lladrovci ka bërë homazhe në sheshin "Fehmi Lladrovci", te shtatorja e Fehmi e Xhevë Lladrovci, Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Bedri Shala, Rasim Këçina e Ilaz Kodra. Kryetari Lladrovci ka bërë homazhe në Kompleksin

Memorial të Jasharëve në Prekaz, në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në Marinë, në varrezat e dëshmorëve në Gllanasellë, Likoshan, Çikatovë e Vjetër, Baicë, Abri, Tërdec, Gllobar, Tërstenik, Vërboc, Shtuticë, Negroc, Krajkovë, Damanek, Shtrubullova, Poklek i Ri dhe i Vjetër dhe në Nekoc. "I përkulemi çdo kontribuuesi për lirinë e pavarësinë e Kosovës, me zotimin se rruga jonë nuk do të ndalet deri në jetësimin e amanetit të më të dashurve tanë që sakrifkuan për ne, për shtet të lirë e të zhvilluar, shtet ligjor e të mirëqenies, shtet të dijes e barazisë", ka thënë Lladrovci.



## Policia rajonale e Gjakovës i jep mirënjohje Begajt

MALISHEVË, 17 SHKURT (ER) - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë, kolonel Lumni Graishta, ka ndarë mirënjohje për kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për bashkëpunimin dhe për përkrahjen për Policinë e Kosovës. Kjo mirënjohje është ndarë në fund të vitit 2020, por i është dorëzuar me rastin e 13-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Në emër të drejtorit të policisë për rajonin e Gjakovës, kolonelit Lumni Graishta, këtë mirënjohje kryetari Begaj ia ka dorëzuar komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, ndërsa në këtë ceremoni ishte i pranishëm



edhe nënkryetari i komunës, Hajdin Berisha. Kryetari Begaj e ka falënderuar Policinë e Kosovës dhe drejtorin Graishta për vlerësimin e bërë për Komunën e Malishevës, po ashtu edhe nënkryetari Berisha e ka falënderuar policinë për vlerësimin e angazhimit të kryetarit Begaj si dhe për bashkëpunimin e mirë mes dy institucioneve.

## Sefer Tasholli dhuron 13 libra për bibliotekën e qytetit në Lipjan

Lipjan, 17 shkurt (ER) - Për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në objektin e bibliotekës është mbajtur ekspozita e qytetit të Lipjanit nga fotografi Valdrin Aliu. Po

ashtu, autori i librit "Lipjani me rrethinë", Sefer Tasholli, ka dhuruar 13 libra për bibliotekën e qytetit për nder të festës së pavarësisë së Kosovës.



## Kuvendi Komunal i Podujevës mban seancë për Ditën e Pavarësisë

PODUJEVË, 17 SHKURT (ER) - Me një mbledhje solemne, Kuvendi i Komunës së Podujevës ka shënuar 13-vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Përveç këshilltarëve, kryetari të komunës, anëtarëve të ekzekutivit, ishin të pranishëm edhe përfaqësues institucionesh lokale, anëtarë të familjeve të dëshmorëve dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së.

Në hapjen e kësaj mbledhje, kryesuesi i Kuvendit, Fatmir Gashi, ka thënë se pas 28 nëntorit të vitit 1912, kur Shqipëria shpalli pavarësinë e saj, 17 shkurti i vitit 2008, dita kur Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran, është ngjarja tjetër më e rëndësishme për të gjithë shqiptarët.

Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, në fjalën e tij tha se më 17 shkurt 2008 Kosova realizoi aspiratën e saj shekullore, shpalljen shtet i pavarur dhe sovran, që pa dyshim është çasti më sublim i gjithë historisë së Kosovës.

Kryetari Bulliqi ka thënë se "vetëm Kosova e pavarur dhe e barabartë për të gjithë është jetësim i përpjekjeve të brezave që u sakrifkuan për liri".

Për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, kryetari Bulliqi bashkë me Shoqatën Breshkatore Alpiniste "Llapi" kanë zhvilluar marshin e ecjes përgjatë fshatrave Lladoc, Herticë dhe Turuqicë dhe kanë bërë homazhe te kompleksi memorial i heroit Hakif Zejnullahu.



# REPUBLIKA



Adem GASHI

## 1. POEZI PËR SHTETIN QË DO (DHE DUA) TË MË BËHET ATDHE

të më bëhesh Dheu i Babës  
epo si  
kur unë jam bërë gjysh  
dhe im nip Aureli  
është vetëm një vit më i ri se ti  
atdhe të më bëhesh dua unë  
dhe do ti  
po djemtë plëngprishës dalzotësit e djeshëm  
t'u bënë zotër tani  
dhe Krishti u ngjall për të 2017-n herë  
dhe sheshit "Shën Tereza"  
i ranë dhjetorit rrezet e diellit të pranvertë  
dua unë dhe do ti  
shteti im të më bëhesh atdhe  
epo, ringjallja nuk qenka edhe aq e lehtë!

(2017)

## 2. NDËRTIMI I SHTËPISË

e nisëm mbi themele të forta prej gjaku  
nuk vajti si deshëm,  
nuk vajti  
muret me gunga i shtrembër oxhaku  
dritaret e pakta i paktë ndriçimi  
terri në skuta, tymi  
kjason nga brenda, pikon së larti  
ah, çatia  
dhe lëngojnë kryepletë, lëngojnë kryeparët  
jo nga kokallat po nga lakmia,  
prekur nga ftohja lëngon dhe dashuria

midis kasolles e pallatit  
ngrehinë me tabelë të llamarintë  
ku të përdredhurat shkronja formojnë emrin  
KOSOVA  
ku fëmijët e jetimtë ngulfaten nga tymi bloza  
e kolla  
ndërtimi i shtëpisë ters na vajti  
sado e ngritur mbi themele të forta

## 3. DITA E KUSHTETUTËS SË KOSOVËS

e martë është sot nëntë prill  
herë tjetër mund të jetë ditë tjetër  
nëntë prill gjithnjë  
sot bie shi  
herë tjetër mund të ketë dhe diell  
në një sfond pëlhure të kaltër  
gjashtë yje të bardhë  
që mund të shtohen ndërkohë e ngaherë  
dhe në mes një blanë e verdhë  
që mund të vizatohet ndryshe nesër  
është një ditë kjo me një dokument në letër  
po shkelësit...  
ah, kjo është punë tjetër


2019

## 4. PEIZAZH REÇAKU MË 1999

zë  
jo, zë njeriu ky nuk është  
lot  
jo, lot nuk nxjerrin zgavrat pa sy  
as qielli nuk lëshon shi  
nën një diell me dhëmb  
si një mamuth parahistorik  
gjak  
jo, gjaku i njeriut nuk është i zi  
djegur nën flakët e gojës lubi  
ah, qenka klithmë mali, shpati,  
klithmë e çnatyruar e peizazhit të Reçakut  
më 1999 ditën e 15 janarit,  
qenka pra  
gurthemeli i Republikës

## 5. ATDHEDASHURI

vendi im është republikë e lirë  
një vend i vogël  
kë dua e takoj në një çast në një orë në një ditë  
madje edhe ata që s'i dua  
që i njoh e s'i njoh  
që më njohin e s'më njohin  
mua  
prandaj është aq i madh  
sa më bën ta dua pafundësisht  
me të gjitha fëlligështitë  
se kam dhe dikë brenda tij  
që dashurisht ma mbjell atdhedashurinë



QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## 'Dardanët', për fitore kundër Luksemburgut

Kosova, sonte, me fillim nga ora 19:00, do ta zhvillojë përballjen me Luksemburgun. Synim ka fitoren për ta vazhduar pastaj ëndrrën për kualifikim. Por për të arritur një gjë të tillë "dardanët" të shtunën duhet të mposhtin edhe Sllovakinë. Sot (e enjte) zhvillohet edhe përballja në mes të Sllovakisë dhe Islandës



**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll sonte (e enjte) do të përballjet me Luksemburgun në kuadër të Dritares së Tretë të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Bordi i FIBA Evropës ka vendosur që të gjitha ndeshjet e kësaj faze do të zhvillohen në Prishtinë, kurse kjo është një përparësi për "dardanët". Përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos, është shprehur se loja pa tifozë është një gjë jo e mirë, por lojtarët duhet ta japin maksimumin për të arritur fitore. "Kemi një ekip të kombinuar mes lojtarëve me përvojë dhe atyre të ri. Jemi duke u përgatitur për të ardhmen dhe njëkohësisht për të tashmen. Kemi dy ndeshje ndaj Luksemburgut dhe Sllovakisë. I kuptojmë vështirësitë me Covid-19, ku lojtarët ende nuk janë 100

% në formë fizike, por u kam thënë djemve se duam të sjellim energji pozitive, sepse përfaqësojmë shtetin, përfaqësojmë Kosovën. Të luash në Kosovë është shumë mirë, por pa tifozë është e tmerrshme, megjithatë lojtarët duhet të mësohen. Pa mbështetjen e tifozëve është sikur të mungojë një element shumë i rëndësishëm në lojën tonë", ka thënë Marmarinos. Edhe një nga basketbollistët më të mirë të Kosovës, Drilon Hajrizi, beson në fitore kundër Luksemburgut dhe Sllovakisë. "Stërvitjet kanë shkuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Kemi cilësi. Gjithashtu, edhe disa lojtarë të rinj janë bashkuar, por edhe disa që na kanë munguar në nëntor na janë bashkangjitur. Kemi cilësi të vazhdojmë tutje. Sa iu përket ndeshjeve, unë jam i bindur se do të angazhohemi maksimalisht, ndërsa sa i përket cilësisë është e

barabartë dhe do të vendosin detajet për të kaluar tutje. Fatkeqësisht, pa tifozë, por do të përpqemi ta shfrytëzojmë përparësinë e terrenit vendas", ka deklaruar Hajrizi. Në Grupin B lidere është Islanda me tri fitore dhe një humbje, kurse Kosova dhe Sllovakia kanë nga dy fitore dhe dy humbje, ndërsa Luksemburgu ka një fitore dhe tri humbje. Të gjitha kombëtares kanë gjasa për kualifikim. Nëse "dardanët" i fitojnë të dyja përballjet, atëherë do të kualifikohen tutje, pa marrë parasysh rezultatet në takimet e tjera.

### ORARI

Të enjten takohen:  
16:00 Sllovakia - Islanda  
19:00 Kosova - Luksemburgu

Më shtunën takohen:  
16:00 Luksemburgu - Islanda  
19:00 Kosova - Sllovakia

## Kosova synon medalje në Izrael

Prishtinë, 17 shkurt - Kosova synon ta rrisë numrin e medaljeve në xhudo në Grand Slamin e Tel Avivit gjatë kësaj jave. Majlinda Kelmendi, Laura Falziu dhe Akil Gjakova do ta përfaqësojnë Kosovën në Grand Slamin e Izraelit sot (e enjte) dhe nesër (e premte). Synimi i ekipit të Kosovës në xhudo është ta përsërisë suksesin e muajit të kaluar, kur i fitoi katër

medalje në Mastersin e Dohas. Kampionia e artë olimpikë, Kelmendi, do ta kalojë rrethin e parë pa luftë në kategorinë 52 kilogramë, ndërsa në rundin e dytë do të përballjet me fituesin e duelit Annika Wurfel - Agata Perenc. Fazliu, ndërkohë, do të ballafaqohet me Habibe Afyonlu e Turqisë në rrethin e parë në kategorinë 63 kilogramë. Gjakova do të ketë

punë me Joao Fernandon e Portugalisë në rrethin e parë në kategorinë 73 kilogramë. Në këtë turne nuk do të marrin pjesë Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Lorian Kuka. Në Mastersin e Dohas në janar, Krasniqi e fitoi medaljen e artë, ndërsa Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe Lorian Kuka fituan medalje të bronzta secila.



### SHKURT

#### Strakosha, bisedime me Dortmundin

Borussia Dortmundi nuk është e kënaqur nga portierët në dispozicion dhe po vështron në gjithë Evropën për të sjellë një gardian cilësor mes katërkëndëshit. Një nga emrat e piketuar është edhe Thomas Strakosha. Gardiani i Lazios mbyll kontratën në verën e vitit 2022 dhe rinovimi nuk është në diskutim. "Sky Sport" raporton se Borussia Dortmundi e ka monitoruar me kujdes situatën e gardianit të kombëtares kuqezi dhe ka nisur kontakte konkrete për ta planifikuar blerjen e tij në verë. Vetë Strakosha është shprehur qartë se është i hapur për aventura të reja dhe se ka një simpati të madhe për Borussia Dortmundi dhe tifozët e klubit të Bundesligas.

#### Komisioni Disiplinor dënon Llapin

Skuadra e Llapit është dënuar me një mijë euro gjobë nga Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Komisioni i shkallës së parë ka mbajtur mbledhje dhe ka shqyrtuar procedurat e hapura nga Komisioni i Garave pas përfundimit të ndeshjeve të fazës së 1/8 të finales në Kupën e Kosovës. Arsyja e dënimit është mosrespektim i masave anti-Covid-19 si dhe hedhja e fishekzjarrëve në min 1, 4 dhe 34. Në minutën e 34-t ndërpritet loja për katër minuta, derisa shikuesit u larguan nga tribunat.

#### Nadali eliminohet nga Australia Open

Tenisti Rafael Nadal ka pësuar humbje befasuese në çerekfinale të Australia Openit. Nadali u mposht nga kundërshtari Stefanos Tsitsipas, që fitoi me rikthim për ta siguruar kualifikimin në gjysmëfinale. 3-6, 2-6, 7-6 (4), 6-4 dhe 7-5 ishin rezultatet në të gjitha raundet, pra Tsitsipas arriti që nga disavantazhi në dy raundet e para të korrë fitore. Tsitsipas tani është në gjysmëfinale të Australia Openit për herë të dytë, ndërsa është bërë lojtari i tretë që ia del që me rikthim ta mposhtë Nadalin.

#### Oferta e Riedit nuk e bindi Nuhiun

Drejtori sportiv i Riedit, Wolfgang Fiala, ka pranuar se kanë qenë deri në fund të afatit kalimtar në bisedime me sulmuesin e Kosovës, Atdhe Nuhiu. Por, ai ka zbuluar të mërkurën se transferimi i Nuhiut dështoi për shkak të çështjes së parave. "Për më tepër kishte shumë detaje për t'u sqaruar, por ato nuk përputheshin nga të dyja palët", ka thënë Fiala në një intervistë dhënë për "LAOLA1".

Sulmuesi 31-vjeçar është pjesë e APOEL Nicosias së Qipros, skuadër që iu bashkua në shtator të vitit të kaluar, ndërsa ka kontratë deri në maj të vitit 2022. Ai këtë edicion ka kontribuar me një asistim në 16 ndeshje.

## KOK-u mbulon shpenzimet e ekipit olimpik të karatesë në Dubai

PRISHTINË, 17 SHKURT - Komiteti Olimpik i Kosovës vazhdon t'i mbështesë sportistët elitare në rrugën drejt fitimit të normës olimpikë "Tokio 2020". Këtë herë KOK-u mbulon shpenzimet e përgatitjeve për tre karateistët elitare: Herolind Nishevci, Elhami Shabani dhe Fortesa Orana, të cilët po

marrin pjesë në kampin përgatitor ndërkombëtar që po mbahet në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe. Të tre karateistët do të përgatiten prej 11-26 shkurt 2021. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë. Po përgatitemi dy herë në ditë, ndërsa kushtet janë shumë të mira. Ka shumë garues. Në

mesin e tyre ka edhe medalistë të Evropës dhe botës, si dhe pretendentë për Lojërat Olimpikë", ka thënë Nishevci. Nishevci, Shabani dhe Orana janë edhe bursistë olimpikë të KOK-ut për "Tokio 2020". Të tre prej vitit 2017 janë duke ndjekur normën olimpikë. Në muajt në vijim i presin garat

ndërkombëtare të vlefshme për normë. Në mars, prill dhe maj i presin Premierë Ligat, të cilat mbahen në Stamboll të Turqisë, Rabat të Marokosë dhe Lisbon të Portugalisë, kurse turneu kualifikues olimpik Tokio 2020 pritet të mbahet në muajin qershor në Paris të Francës.



## Bujar Qerimi emërohet selektor i Kosovës

PRISHTINË, 17 SHKURT - Bujar Qerimi është emëruar selektor i Kosovës në hendboll (meshkujt). Vendimin e mori bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës. Emri i njohur i hendbollit të Kosovës do të jetë në krye të ekipit përfaqësues në katër ndeshjet e fazës së dytë kualifikuese për "Euro 2022". Kosova më 10 mars e pret Rumaninë në Prishtinë, ndërsa më 14 mars luan ndaj Rumanisë si mysafire. Në fund të prillit Kombëtarja jonë e pret Malin e Zi, kurse në fillim të majit luan si mysafire ndaj nënkampionës së botës, Suedisë. "Bordi ka marrë vendim për selektorin pas situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 që ka prekur sportin në gjithë botën. Për shkak të kufizimeve në udhëtim, selektori i



deritashëm, Taip Ramadani, e ka të pamundur që të udhëtojë nga Australia që të jetë në krye të ekipit. Për këtë arsye

Ramadani ka ofruar dorëheqje. Bordi, duke çmuar kontributin e Ramadani, ka vendosur ta pranojë dorëheqjen, duke u bazuar në rrethanat e krijuara. Bordi i FHK-së ka vendosur që pozitën e selektorit t'ia besojë ish-lojtarit të Borc-it të Ferizajt, Bujar Qerimit", thuhet në njoftimin e Federatës së Hendbollit të Kosovës.

Qerimi ka bërë karrierë si trajner në Belgjikë, kurse së fundi ishte seleksionues i U-20 të Belgjikës. Tani Qerimi do të jetë në krye të "dardanëve" për këto katër ndeshje. FHK-ja ishte e interesuar edhe për trajnerët e tjerë shqiptarë, Jasmin Zhuta e Ibish Thaqi, por kësaj radhe u vendos për Bujar Qerimin, një emër i respektuar i hendbollit të Kosovës.

## Lakersat u rikthehen fitoreve

MINNESOTA, 17 SHKURT - Los Angeles Lakersi rikthehet te fitorja dhe e bën këtë me shifrat 104-112 në transfertën e "Target Center" ndaj Minnesota Timberwolves. Vetëm dy ditë pas humbjes me Denver Nuggetsin, kalifornianët reagojnë në mënyrën më të mirë, ndonëse duhet pranuar se suksesi në Minnesota nuk ishte aspak i lehtë. LeBron Jamesi ishte protagonist për Lakersat, pasi arriti të shënojë 30 pikë, të rikuperojë 13 topa dhe të japë 7 asistime, ndërsa ylli tjetër i skuadrës Anthony Davis vijon të qëndrojë jashtë parketit për shkak të një dëmtimi, raporton "Supersport". Vijon të bëjë mirë edhe Brooklyn Netsi, që mposhti Phoenix Suns-in me shifrat 124-128 në një nga sfidat më spektakolare të javës. James Hardeni ishte protagonist i padiskutuashëm i Netsit, me 38 pikë të shënuara, 7 rikuperime dhe 11 asistime, duke



kontribuar në përmbyse të rezultatit. Phoenixi e nisi në mënyrë të përkryer ndeshjen dhe kur kishte mbaruar gjysma e lojës, vendësit kryesonin me rezultatit e thellë 75-55, megjithatë reagimi i Brooklynit ishte fantastik në gjysmën e dytë, pasi ia doli ta përmbyse gjithçka dhe të marrë fitoren e katërt radhazi. Ka fituar edhe Portland Trail Blazersi, që iu imponua Oklahoma City Thunderit me shifrat 104-115

dhe regjistroi suksesin e pestë radhazi në kampionat, që vijon ta ngjitet në renditje. Lillardit ishte protagonist i Trail Blazersit me 31 pikë të shënuara, 7 rikuperime dhe 10 asistime. Në sfidat e tjera Boston Celticsi mposhti Denver Nuggetsin me shifrat 112-99, New Orleans Pelicansi triumfoi me rezultatit e thellë 113-144 dhe Toronto Raptorsi mposhti Milwaukee Bucksin me shifrat 113-124.

### SHKURT

#### Pochettino: Ishte ndeshje fantastike, njëjtë edhe në Paris

PSG-ja ka shkëlqyer në ndeshjen kundër Barcelonës në "Camp Nou" duke fituar me rezultat 1-4, por trajneri Mauricio Pochettino ka kërkuar nga futbollistët e tij të bëjnë të njëjtën gjë edhe në ndeshjen e kthimit. "Kemi dhuruar një paraqitje të mirë duke e dituar se ndeshje të tilla zgjasin 180 minuta. Më bëhet qejfi për rezultatit e arritur. Na jep besim për ta përballuar ndeshjen që vjen tani. Në Paris duhet të luajmë me të njëjtin ritëm", ka thënë Pochettino duke u ndalur më pas te Mbappe: "Është e qartë që Kylian është një lojtar i madh. E demonstroi në 'Camp Nou'. Ka bërë një punë të madhe për skuadrën, përveç se shënoi edhe tre gola", ka shtuar Pochettino.

#### Wilder: Dua të përballem me Ruizin, Joshuan e në fund me Furyn

Boksieri amerikan Deontay Wilder, ish-kampion bote në peshën e rëndë (WBC), nuk duhet të kaluar kur humbi titullin në përballjen ndaj Tyson Furyt. Një vit i vështirë për Wilder-in, që pësoi humbjen e parë në karrierë dhe ende nuk ka mundur të rikuperojë nga kjo goditje. Gjithsesi, amerikanin kërkon të rikthehet protagonist, duke synuar përballjen dhe fitoren me tre boksierët më të mirë të këtij Divizioni: Meksikanin Andy Ruiz Jr (ish-kampion bote) dhe britanikët Anthony Joshua e Tyson Fury. Duke folur në një intervistë, Wilder ka thënë: "Dua të përballem me Ruizin, Joshuan e në fund me Furyn. Dua ta spastroj Divizionin tonë nga këta emra dhe ta rimarr atë që më takon. Do të dueloj dhe të fitoj ndaj të gjithëve".

#### Kloppi: Shumëkush e priti dështimin tonë ndaj Leipzigut

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, është shprehur mjaft i lumtur për fitoren 2-0 kundër RB Leipzigut në Ligën e Kampionëve. Trajneri gjerman ka thënë se shumëkush e ka pritur dështimin e Liverpoolit në këtë ndeshje mjaft të rëndësishme. "Luajtëm shumë mirë dhe e meritua fitoren, por është vetëm ndeshja e parë. Shumë njerëz prisnin që ne të bëjmë tjetër lëshim dhe sonte nuk e bëmë. Jam shumë i lumtur", ka thënë Klopp.

#### Laporta: Do bëj gjithçka që ta mbaj Messin

Kandidati kryesor për postin e presidentit të Barcelonës, Joan Laporta, ka thënë se do të bëjë çmos që ta mbajë Lionel Messin në skuadër. "Duhet të kemi ofertë garuese sportive. Është fitues dhe dëshiron të fitojë me Barcelonën. Do të bëj gjithçka që është e mundur. Ka shumë që e duan dhe ne kemi nevojë për një ofertë të rëndësishme. Paratë nuk garantojnë tituj", ka thënë Laporta. "Messi sjell më shumë para se shpenzime. Për Barcelonën është më e rëndësishmja kur e pyesin kur është më i miri në botë. Ata thonë Messi menjëherë", ka shtuar Laporta.

## Gerrard: M'u thye zemra kur u largua Torresi

Ka luajtur me shumë kampionë dhe ka parë të largohen shumë sulmues nga "Anfield Road", nga Robert Fowler, te Michael Owen dhe

Luis Suarez, por ish-kapiteni i Liverpoolit, Stiven Gerrard, thotë se i vetmi që ia ka thyer zemrën pas largimit ishte Fernando Torres. Sulmuesi

spanjoll u transferua te Chelsea në janar 2011 pasi shënoi 81 gola në 142 ndeshje me "Reds"-at. "Nuk luajta shumë gjatë me Torresin, sepse

ai shkoi te Chelsea dhe më theu zemrën. Nëse më pyesni se cili ishte lojtari më i mirë sa i përket formës së përditshme, Luis Suarez ishte një bishë, por

vitet e mia më të mira i kalova me Fernando Torresin sa i përket mënyrës se si u ndjeva. Isha shumë i zhgënjyer kur ai u largua", ka thënë Gerrardi.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



ISBN 978-9951-780-10-0

9 789951 780100

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

